

1 E mërkurë, 3 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e  
6 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të  
8 nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori  
9 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
12 Dhe mirëmëngjesi, të gjithëve.

13 Për procesverbal, të katër të akuzuarit janë të pranishëm  
14 në sallën e gjyqit.

15 Sot do të rivijojmë me dëshminë e Dëshmitar 04147 dhe të  
16 përfundojmë me të dhe më pas do të rikthehet Dëshmitari 04739.

17 Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë. Dhe ju  
18 lutem të jemi në seancë publike.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,  
22 z. Byrnes.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes. Uroj të keni kaluar  
24 një fundjavë të këndshme të Pashkëve.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Uroj dhe ju të keni pasur një fundjavë të këndshme.

2 Dëshmitar, shpresojmë që ju ta përfundoni dëshminë brenda  
3 një ose dy orësh. Ju rikujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve qartë  
4 me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetjeje, lirisht  
5 kërkoni që pyetja të përgjigjet ose të thoni që nuk e kuptoni  
6 në mënyrë që ta sqarojnë. Gjithashtu, mos harroni të thoni ku  
7 e bazoni njohurinë për faktet dhe rrethanat për të cilat do  
8 t'ju bëjnë pyetje.

9 Gjithashtu ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të  
10 thënë të vërtetën sikurse vetë e thatë përmes deklaratës  
11 solemne.

12 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se  
13 të përgjigjeni si dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju ndjekin  
14 edhe përkthyesit.

15 Nëse keni nevojë për pushime, na thoni dhe do bëjmë  
16 organizimet e nevojshme.

17 Dëshmitar, pyetjet i ka ekipi i Mbrojtjes së Krasniqit. E  
18 shihni që z. Ellis është në këmbë.

19 Z. Ellis, fjala është për ju.

20 DËSHMITARI: SHAUN BYRNES [Vijon]

21 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

22 [Vazhdim]

23 Z. ELLIS: [Përkthim]

24 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

25 PË. Mirëmëngjesi.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 3

1           Z. ELLIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për pyetjet e  
2 para kam nevojë të kalojmë në seancë private me kërkesë të  
3 ofruesit të informacionit.

4           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë  
5 në seancë private me kërkesë të ofruesit të informacionit.

6                           [Seancë private]

7                           [Seancë private teksti i fshirë]

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 4

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 5

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 6

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 7

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 8

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 9

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të

15 hapur.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, Z.

17 Ellis.

18 Z. ELLIS: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, kam edhe disa tema të shkurtra që dua të

20 trajtoj me ju. E para lidhet me një pyetje që bëri Gjykatësi

21 Mettraux më 28 mars dhe kjo është reflektuar në faqen 1400 të

22 transkriptit, në rreshtin 18, ju pyeti nëse jeni në dijeni që

23 z. Krasniqi krahas rolit të tij si zëdhënës ishte emëruar edhe

24 zëvendëskomandant për shërbimet mbështetëse pranë Shtabit të

25 Përgjithshëm. Ju u përgjigjët:

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 10

1 "Jo, nuk kam pasur dijeni për këtë".

2 A është e vërtetë që gjatë gjithë bisedave që keni pasur  
3 me z. Krasniqi ai asnjëherë nuk ju ka thënë se ka qenë dhe  
4 zëvendëskomandant për shërbimet mbështetëse?

5 PË. Jo.

6 PY. Gjithmonë ka thënë që ka qenë zëdhënës?

7 PË. Po.

8 PY. Aso kohe apo dhe më vonë a keni qenë në dijeni se, në  
9 fakt, ka qenë Sokol Bashota zëvendëskomandanti dhe pak më vonë  
10 zëvendëskomandant për operacionet?

11 PË. Aso kohe nuk kam qenë në dijeni.

12 PY. Në rregull. Gjykatësi Barthe ju bëri një pyetje më 27  
13 mars, kjo është në faqen 13935 të transkriptit, ju pyeti për  
14 paragrafin 28 të deklaratës tuaj si dëshmitar dhe unë po jua  
15 lexoj. Ju pyeti:

16 "Në shtator ose nëntor të 1998 ngrita problemin e  
17 vrasjeve brenda për brenda shqiptarëve dhe të bashkëpunëtorëve  
18 me trojkën, ata e mohuan kategorikisht të kishte ndodhur një  
19 gjë e tillë."

20 Dhe z. Misetic ju bëri disa pyetje vijuese në lidhje me  
21 këtë të enjten. Dhe ju u përgjigjët dhe thatë "se kjo mbase ka  
22 lidhje me vrasjen e pretenduar të katolikëve shqiptarë në  
23 Gjakovë". Ju kujtohet?

24 PË. Po.

25 PY. Pamë bashkë kabllogramin e KDOM-it të SHBA-së më 3 nëntor

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis (Vazhdim)

Faqe 11

1 të 1998 ku ju thoni se nuk e kishit parë z. Krasniqi dhe  
2 kishit kohë që nuk kishit biseduar me të. Ju kujtohet ky  
3 kabllogram?

4 PË. Po.

5 PY. A është e vërtetë që pikë kontakti apo pika kryesore juaja  
6 e kontaktit ishte Sokol Bashota dhe gjatë kësaj kohe keni  
7 pasur kontakte të vazhdueshme me të?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe është e vërtetë që ndonjëherë kishit dhe thirrje  
10 telefonike me Ramë Bujën?

11 PË. Po.

12 PY. Kur thoni në deklaratën tuaj që kjo problematikë është  
13 trajtuar me trojkën në shtator të 1998 mund të ketë ndodhur që  
14 ju keni folur në telefon me z. Bashota ose z. Buja?

15 PË. Çështja e vrasjeve brenda për brenda shqiptarëve?

16 PË. Po, po. Ju ia sqaruat pastaj z. Misetic, i thatë mund të  
17 ketë lidhje me katolikët e Gjakovës.

18 PË. Z. Ellis, ju lutem përsëriteni dhe një herë pyetjen?

19 PY. Patjetër. Pyetja ime është kjo: Kur thatë kjo  
20 problematikë u trajtua me trojkën në shtator apo nëntor të  
21 1998, a mund të ketë ndodhur që ju të keni folur në telefon me  
22 z. Bashota apo z. Buja?

23 PË. Ka shumë të ngjarë.

24 PY. Dhe, në fakt, sa herë thoni ju në deklaratat tuaja që  
25 këtë e kam trajtuar me trojkën, kjo mund të ketë ndodhur me

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 12

1 çdo person të mundshëm të trojkës përmes thirrjeve telefonike?

2 PË. Po.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Një çast, të nderuar Gjykatës.

5 PY. Dhe nëse keni biseduar me një prej anëtarëve në telefon,

6 ju nuk e dinit nëse ajo që thonit ju në telefon u komunikoj

7 të tjerëve, pra ju nuk e dinit çfarë ndodhte pas kuintave?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
10 Ellis.

11 Z. Emmerson, fjala është për ju.

12 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

13 Z. EMMERSON: [Përkthim]

14 PY. Mirëmëngjes. Me sa keni ju dijeni, do të doja të flisja

15 pak për dy seancat apo dy takimet e Rambujesë, të parin edhe

16 më pas do flasim për të dytin?

17 Pyetja ime është kjo, pra, a mund të na thoni kur është

18 mbajtur takimi i parë i Rambujesë dhe takimi i dytë i

19 Rambujesë?

20 PË. S'mund t'ua them tani kështu shpejt e shpejt.

21 PY. Në rregull. Do t'i gjej datat unë.

22 Nëse është e mundshme, do të doja të fokusoheshim në dy

23 aspekte të pyetjeve të gjykatësve. I pari aspekt lidhet me një

24 pyetje që ua bëri Gjykatësi Barthe më 27 mars në faqen 13939,

25 në rreshtin 12. Gjykatësi Barthe ju bëri këtë pyetje:

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 13

1            "... Z. Byrnes, lidhur me një aspekt të ngjashëm, që nuk  
2 është tërësisht i qartë për Trupin Gjykses, a keni pasur ju  
3 ndonjë njohuri personale aso kohe që do të thotë në 1998 apo  
4 1999, lidhur me vendndodhjen e z. Veseli nga nëntori i 1998 e  
5 në vijim apo se çfarë bënte?"

6            Dhe ju u përgjigjët kështu:

7            "I vetmi informacion që kishim ishte që z. Veseli ishte  
8 në Shqipëri dhe nuk e dinim se çfarë përgjegjësish kishte.  
9 Kishte fjalë, por ne nuk dinim gjë konkretisht, informata  
10 konkrete nuk kishim që të vleftësonim përgjegjësitë e tij."

11           Dhe më pas Gjykatësi Barthe sqaron dhe thotë, përveç  
12 fjalëve, ju konkretisht ju nuk e dinit se çfarë bënte ai në  
13 Shqipëri dhe ju përgjigjeni po kështu është.

14           Ju kujtohet kjo pyetje dhe përgjigja juaj?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, fjalët e përhapura se çfarë bënte z. Veseli në  
17 Shqipëri, këto fjalë kishin të bënim me komunikimin e tij me  
18 SHIK-un shqiptar apo me shërbime të tjera të shërbimit  
19 informativ?

20 PË. Nuk më kujtohet.

21 PY. Pra, nuk ju kujtohet se çfarë fjalësh ishin këto?

22 PË. Jo, nuk më kujtohet.

23 PY. Në rregull.

24           Dua t'ju bëj nja dy pyetje të tjera tani për lidhjen që  
25 kanë këto data me pyetjet dhe përgjigjet që i dhatë Gjykatësit

1 Barthe si dhe pyetjet që ju bëri Gjykatësi Mettraux për  
2 secilën nga rastet e rrëmbimit dhe të lirimit. Do filloj me  
3 gazetarët e Tanjugut serbë, arrestimin e Cen Deskut, Jakup  
4 Kastratit edhe më pas për ndalimin dhe lirimin e Goran Zbilic,  
5 dhe më pas lirimin e gazetarëve të Tanjugut në Dragobil, si  
6 dhe ndalimin dhe lirimin e tetë ushtarëve jugosllavë.

7 Vetëm një çast.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dosja e  
9 pasaportave që na kanë dhënë autoritetet zvicerane që mbajnë  
10 lëvizjet e z. Veseli në këtë periudhë është e përfshirë në  
11 listën tonë të materialeve dhe mban numrin DKV1215 deri në  
12 DKV1234. Një version i këtij dokumenti është pranuar tashmë në  
13 provat gjyqësore dhe ka marrë numrin D. Po kjo është një dosje  
14 që ka edhe dokumentacionin e autorizimet nga autoritetet  
15 zvicerane që na ndihmuan për të marrë dokumentet.

16 Nuk dua të shfrytëzoj kohën e Gjykatës, por nëse keni  
17 nevojë, unë jam i gatshëm t'i shikojmë një për një vulat.  
18 Megjithatë, unë po ju them këtë, të flasim për faktet për  
19 hyrje nga periudha e 11 tetorit të 1998 deri më 13 janar 1999  
20 dhe do të përmbledh atë që gjendet aty. S'është nevoja t'i  
21 shohim një për një vulat. Megjithatë do të doja të tregoja  
22 kronologjinë ngjarjeve për të cilat i bëri pyetje Gjykatësi  
23 Mettraux dëshmitarit.

24 PY. Atëherë do lutesha ose mbase mënyra më e thjeshtë është  
25 të flasim për kronologjinë që e diskutuat më shumë se një herë

1 për ndalimet, arrestimet dhe lirimet e personave që citova më  
2 herët. Edhe unë do flas për kronologjinë sepse ka qenë disi,  
3 ka pasur edhe mbivendosje herë pas here mes ndalimeve dhe  
4 lirimeve. Prandaj unë do flas për datat që kanë dalë gjatë  
5 pyetjeve që u bënë ju edhe që herë pas here dhe janë  
6 konfirmuar prej dokumentacionit tuaj apo dokumente të tjera të  
7 asaj kohe.

8 Incidenti i parë është i datës 18 tetor 1998, që është  
9 ndalimi i dy gazetarëve serbë të Tanjugut, Dobricic dhe  
10 Radosevic.

11 Ndërkohë, data tjetër e rëndësishme është data 13 tetor,  
12 që është data e ndalimit të Cen Deskut dhe Jakup Kastratit, të  
13 cilët janë dy zyrtarët e LDK-së të arrestuar në këtë datë.

14 Pas këtyre dy arrestimeve, data tjetër ose ngjarja tjetër  
15 e rëndësishme për diskutimet tona është data 17 nëntor 1998 në  
16 kohën kur polici serb Goran Zbilic arrestohet dhe, sipas  
17 procesverbalit, ky është një person i cili është liruar pas  
18 një jave, që i takon që është liruar më datë 24 nëntor.

19 Tre ditë më pas më datë 27 nëntor ndalohen gazetarët e  
20 Tanjugut dhe zyrtarët e LDK-së, në fakt, më datë 27 nëntor i  
21 takon që gazetarët e Tanjugut dhe zyrtarët e LDK-së, të dyja  
22 grupet, lirohen në Dragobil.

23 Pastaj një tjetër ngjarje e rëndësishme për diskutimin  
24 tonë është arrestimi dhe lirimi i tetë ushtarëve të armatës  
25 jugosllave që ka ndodhur më datë 8 janar 1999, domethënë, në

1 këtë datë ka ndodhur arrestimi i tyre, ata janë zënë nga UÇK-  
2 ja në një zonë në Mitrovicë, dhe ju na e thatë gjatë dëshmisë  
3 tuaj që ata kishin humbur rrugën, ishin në këtë zonë që  
4 kontrollohej nga UÇK-ja dhe u kapën prej tyre dhe janë marrë  
5 si të burgosur lufte dhe këta janë persona të cilët janë  
6 liruar më datë 13 janar.

7 Domethënë, kjo është kronologjia e ndalimeve dhe e  
8 lirimeve të këtyre personave, po ashtu dua t'ju informoj për  
9 të dhënat e pasaportës.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Por përpara sesa ta bëj këtë, do  
11 i kërkoja Sekretares të paraqesë në ekran një dokument që e  
12 kemi parë disa herë deri tani. Për procesverbal, është prova  
13 P652. Përveç tekstit në anglisht është edhe teksti në shqip.  
14 Ju lutem paraqiteni të dyja përbri njëra-tjetrës.  
15 Faleminderit.

16 PY. Ky është një dokument të cilin ne e kemi përmendur si  
17 marrëveshja e FARK-ut, është marrëveshja e FARK-ut që është  
18 arritur në Tiranë ndërmjet përfaqësuesve të forcave të  
19 armatosura të Qeverisë në Ekzil, pra, Qeverisë së Bukshit, që  
20 përfaqësohej nga një person që quhej Halil Bicaj, që juve  
21 thatë në mos gabohem, që ishte një emër që nuk e kishit  
22 dëgjuar, me të cilin nuk është se ishit shumë i njohur. Pra,  
23 nga njëra anë ishte Halil Bicaj dhe nga ana tjetër ishte  
24 Bislum Zyrapi. Në rastin e z. Bicaj, ai ndihmohej nga Xhaferr  
25 Jashari dhe në rastin e Bislum Zyrapit, ai mbështetej nga



Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 17

1 Kadri Veseli. Dhe pastaj kemi dhe dy persona të tjerë që ishin  
2 përfaqësues të të dy kaheve ose të dyja anëve që ishin të  
3 pranishëm në këtë marrëveshje.

4 Pra, kjo është një marrëveshje për të cilën palët kanë  
5 rënë dakord në Tiranë, pra, është një marrëveshje që është  
6 negociuar dhe është miratuar në Tiranë.

7 Nëse do të shikojmë kreun e faqes, aty vëmë re që  
8 miratimi i kësaj marrëveshjeje ka ardhur si rezultat i shumë  
9 proceseve të ndryshme në Tiranë, po në fund fare data e  
10 nënshkrimit të marrëveshjes është 31 tetor 1998 në praninë e  
11 individëve ose personave që i shikoni në ekran duke përfshirë  
12 këtu edhe Kadri Veselin për të cilin jemi të interesuar. A  
13 mund ta shikoni emrin e Kadri Veselit në ekran, Dëshmitar?  
14 PË. Po.

15 PY. Por nga ana tjetër marrja e Cen Deskut e Jakup Kastriotit  
16 ka ndodhur një ditë më përpara sesa të nënshkruhej kjo  
17 marrëveshje, ndërkohë që të gjithë personat, emrat e të cilëve  
18 ju mund t'i shikoni në ekran, kanë qenë të përfshirë në  
19 negocimin e marrëveshjes.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shikoj që doni të thoni diçka,  
21 Gjykatës?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pres për  
23 pyetjen.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, do të ketë një pyetje  
25 patjetër. Por ideja është që unë dua ta pyes dëshmitarin në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 18

1 qoftë se informacioni që ai ka, mbështet përgjigjen që i ka  
2 dhënë në pyetje të Gjykatësit Barthe.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po jep  
4 edhe përgjigjen përveçse pyetjen.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po këtë pyetje kam, kjo ishte në  
6 përgjigje të pyetjes tuaj.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kemi  
8 dhjetë minuta që dëgjojmë përmbledhjen.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Do t'ia bëj në këtë  
10 mënyrë pyetjen dëshmitarit.

11 PY. Dhe, në fakt, po përdor të njëjtin format ose të njëjtën  
12 formë që ka përdorur dhe Gjykatësi Mettraux.

13 Pyetja është kjo: A pajtoheni me mua se në qoftë se është  
14 e saktë se ka pasur disa takime në Tiranë të cilat kanë çuar  
15 përfundimisht në nënshkrimin e këtij dokumenti nga z. Veseli  
16 dhe të tjerë më 31 tetor 1998, atëherë i takon që ai nuk ka  
17 pas mundësi që të jetë i pranishëm në Kosovë në kohën e  
18 arrestimit dhe ndalimit të Cen Deskut dhe po ashtu nuk ka qenë  
19 në Kosovë as në kohën kur janë arrestuar dy gazetarët e  
20 Tanjugut, a pajtoheni me mua lidhur me këtë parashtrim që ju  
21 bëra, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për  
24 procesverbal ne kërkojmë që pyetjet plotësuese të jenë të  
25 kufizuara, domethënë, ose të kufizohen në kohën në dispozicion

1 të avokatëve ose të temave për të cilat duhet të bëhen pyetje.  
2 Ne nuk mendojmë që avokatët duhet të kenë mundësinë që të  
3 bëjnë çfarëdolloj pyetjeje që të munden. Dhe ky është një  
4 dëshmitar i cili e ka thënë shumë herë që nuk e ka njohur, nuk  
5 e ka ditur se ku ka qenë z. Veseli. E ka thënë këtë gjë edhe  
6 në pyetjet që kemi bërë më përpara dhe në pyetjet që kanë bërë  
7 kolegët e tjerë.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Patjetër, ai e tha që nuk e dinte  
9 se çfarë bënte z. Veseli po nga ana tjetër unë i tregova  
10 dokumentet dhe kjo është një vlerë e shtuar dhe është një  
11 pistë që neve na shërben si Mbrojtje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
13 vazhdoni, z. Emmerson.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]  
15 PY. Pasaportën që e kemi paraqitur si provë, si listë të  
16 materialeve tona tregon lëvizjet e z. Veseli. Kemi tetë vula  
17 të datave të hyrjeve dhe daljeve. Ndërkohë më datën 11 tetor  
18 1998 është një vulë në pasaportën e z. Veseli që tregon që ai  
19 është larguar me avion në aeroport në Bern, në Zvicër. Dhe të  
20 njëjtën ditë ka një tjetër vulë në pasaportën e tij që tregon  
21 që është futur në aeroportin e Rinasit në Tiranë. Pra, të  
22 njëjtën datë, të njëjtën ditë.

23 Kështu që do ju kërkoj që të sqaroni dy aspekte,  
24 Dëshmitar. E para nuk do ishte e mundur që z. Veseli të  
25 fluturonte nga aeroporti i Prishtinës në asnjë kohë në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Page 20

1 periudhën nga tetori i 1998 deri në fund të luftës. A

2 pajtoheni me mua lidhur me këtë, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit. Pra, mund ta shohim që më datë 11 tetor ai

5 ka fluturuar me avion nga Zvicra, në Bern në Zvicër drejt

6 Shqipërisë. Kështu që i takon që ai ka qenë diku tjetër, jo në

7 Kosovë, domethënë, ose në Shqipëri apo edhe në Zvicër përpara

8 sesa ta fillonte këtë udhëtim, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. A është kjo në pajtim me atë çfarë kishit kuptuar ju që

11 z. Veseli ka qenë jashtë Kosove gjatë periudhës që diskutojmë,

12 pavarësisht nga fakti që e dinit ose s'e dinit ju se çfarë po

13 bënte z. Veseli?

14 PË. Po.

15 PY. Po flasim sërish për nëntorin, në pasaportën e z. Veseli

16 kemi një vulë më datën 19 nëntor që tregon që ai është larguar

17 nga aeroporti i Rinasit në Tiranë me avion duke shkuar në një

18 vend tjetër. Në nëntor nuk ka një vulë tjetër në këtë datë sa

19 i takon mbërritjes. Megjithatë besoj që pajtoheni me mua që

20 duke qenë që ka ardhur më datë 1 tetor, ai është larguar diku

21 rreth datës 19 nëntor, përderisa datën 19 nëntor kemi stampë

22 në pasaportën e tij.

23 Në qoftë se tani trajtuam arrestimin e gazetarëve dhe

24 zyrtarëve të LDK-së, tani kalojmë tek incidenti ose tek rasti

25 i dytë. Kemi 17 nëntorin që është data e dytë e rëndësishme,

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 21

1 sepse kjo ka të bëjë me arrestimin e Goran Zbiliqit, ndërkohë  
2 që më 24, sikurse e thamë edhe më lartë, Goran Zbilic u lirua.  
3 Pra, pavarësisht se çfarë mund të jetë qëndrimi lidhur me  
4 arrestimin e këtij personi, ne jemi të sigurt që z. Veseli nuk  
5 ka qenë aty sepse, sikurse e tregova më sipër, z. Veseli është  
6 larguar nga Shqipëria në drejtim të një vendi tjetër dhe ka  
7 arritur në të njëjtën kohë, domethënë, në kohën ndërmjet  
8 arrestimit dhe lirimit të tyre. A përkon kjo me atë çfarë keni  
9 kuptuar ju, Dëshmitar?

10 PË. Po. Por më lejoni të bëj një korrigjim. Ju thatë më herët  
11 që ai ka mbërritur në Tiranë më 11 tetor, por tani thatë që ka  
12 arritur më 1 tetor.

13 PY. Ju kërkoi ndjesë. E kam thënë gabim, lapsus, në qoftë se  
14 e thashë këtë gjë. Por po e them dhe një herë që ai ka  
15 mbërritur në Shqipëri nga Zvicra më datën 11 tetor, ndërkohë  
16 që vula tjetër në pasaportën e z. Veseli është data 19 tetor,  
17 çfarë tregon që ai është larguar nga Tirana, domethënë, pasi  
18 ka hyrë në Tiranë më 11 tetor më 19 është larguar nga Tirana  
19 në drejtim të një shteti tjetër.

20 PË. Përsëri në përgjigje të pyetjes që ju sapo bëtë,  
21 përgjigja ime është, po, pajtohem me atë çfarë thatë.

22 PY. Në rregull. Tani më 27 nëntor, gazetarët e Tanjugut dhe  
23 zyrtarët e LDK-së u liruan në Dragobil. Në atë kohë, ndërkohë  
24 që z. Veseli ishte larguar nga aeroporti i Tiranës, hyrja  
25 tjetër, sipas vulave në pasaportën e tij, e tregon atë që ka

1 qenë në Bernë në Zvicër, më datë 11 dhjetor, ku iu zgjat edhe  
2 viza që kishte dhe më pas është larguar të njëjtën datë nga  
3 Zvicra, domethënë, më datë 11 dhjetor. Dhe nuk është kthyer  
4 deri më 31 dhjetor në Tiranë, domethënë, në aeroportin e  
5 Tiranës.

6 A do pajtoheshit me mua se mbështetur në vulat që ka në  
7 pasaportë z. Veseli, ai nuk ka qenë në vend, domethënë, në  
8 Kosovë, madje as edhe në Shqipëri në kohën kur janë bërë  
9 organizimet për lirimin e gazetarëve të Tanjugut dhe zyrtarëve  
10 të LDK-së, Cen Desku dhe Jakup Kastrati?

11 PË. Po, kështu duket se ka qenë.

12 PY. Faleminderit. Tani le të vijojmë më tej, të kalojmë tek  
13 janari, sepse në janar pasaporta e z. Veseli ka tri stampa,  
14 vula. Njëra vulë është më datën 5 janar. Pra, pasi ishte  
15 larguar nga Tirana më 31 dhjetor, z. Veseli më pas në  
16 pasaportën e tij ka një vulë që tregon që ai ka mbërritur në  
17 Bruksel, në Belgjikë, më datën 5 janar. Është e qartë që z.  
18 Veseli ka qëndruar në Belgjikë në periudhën nga 5 deri më 10  
19 janar sepse në pasaportën e tij ka një vulë që tregon që ai  
20 është larguar nga Brukseli me avion më datën 10 janar.

21 Domethënë, në periudhën nga 5 janari deri më 10 janar ai ka  
22 qenë në Bruksel dhe është larguar nga Brukseli më datën 10  
23 janar, përsëri edhe në këtë rast nuk është e qartë se ku ka  
24 shkuar në rastin e parë, megjithatë më datën 13 janar në  
25 pasaportë, pra, vula në pasaportë tregon që ai ka mbërritur në

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 23

1 Slloveni.

2 Pra, me këto vula është e sigurt që z. Veseli jo vetëm që  
3 ka qenë jashtë Kosove, jashtë Shqipërie, por ka qenë në  
4 perëndim, në Evropën Perëndimore gjatë gjithë kohës kur janë  
5 arrestuar dhe më pas janë liruar si zyrtarët e LDK-së ashtu  
6 edhe ushtarët e armatës jugosllave?

7 PË. Është dukshme, është e qartë që unë nuk e kam idenë se ku  
8 do ketë qenë ai në periudhën nga 10 janari deri më 13 janar,  
9 por besoj që pajtohem juve që nuk ka qenë në Kosovë.

10 PY. Pa diskutim që nuk ka qenë Kosovë.

11 PË. Po.

12 PY. Në qoftë se do shikojmë datat arrestimi është bërë më 8  
13 janar dhe pastaj ka shkuar në Belgjikë?

14 PË. Po.

15 PY. Po. Dhe pastaj ne e dimë që lirimi ka ndodhur më datë 13  
16 janar ndërkohë që ai ka qenë në Fernetici, në Slloveni sipas  
17 vulës që ka në pasaportë dhe i takon që z. Veseli nuk ka pasur  
18 pikë lidhje as me marrjen dhe as me lirin e këtyre personave  
19 për aq kohë sa nuk ka qenë fare aty?

20 PË. Ai mund të ketë qenë i përfshirë në diskutime në çështje  
21 të tilla përmes telefonave, përmes thirrjeve telefonike.

22 PY. Mirë, në rregull. Megjithatë ju konfirmoni, apo jo, që z.  
23 Veseli nuk ka qenë në Kosovë ka qenë jashtë Kosove në  
24 periudhën për të cilën ne po flasim dhe ky është një  
25 parashtrim i bazuar, me themel, apo jo?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 24

1 PË. Po.

2 PY. Tani sa i takon kontekstit duam që të shohim bashkë një  
3 dokument të cilin e keni parë disa herë gjatë dëshmisë tuaj,  
4 kam përshtypjen që herën e fundit e diskutuat këtë dokument me  
5 Gjykatësin Mettraux, për procesverbal është prova materiale  
6 P303. Sa i takon pyetjes, nuk e kam referencën, ju kërkoj  
7 ndjesë për këtë, po jam i sigurt që nuk do ketë kundërshtime  
8 sepse është një pyetje që e kemi dëgjuar të gjithë nga  
9 Gjykatësi Mettraux.

10 Ky është dokumenti --

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, është faqja  
12 tjetër.

13 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, përkthimi është në faqen  
14 tjetër. Është dokumenti 043862 në fund. Nuk e di në qoftë se  
15 kemi artikullin përkatës në shqip, megjithatë nuk është shumë  
16 e rëndësishme sepse dëshmitari do të na ndjekë në versionin në  
17 anglisht.

18 PY. Dua t'jua këtë pyetje, Dëshmitar, sepse mund ta shikoni  
19 që në paragrafin e dytë përshkruhet arrestimi i dy zyrtarëve  
20 të LDK-së, që ka ndodhur më datë 30 tetor, një ditë përpara  
21 sesa të nënshkruhej marrëveshja që diskutuam pak më herët në  
22 Tiranë, pra, marrëveshjen në bashkëpunim me FARK-un. Pra, data  
23 30 tetor është data e arrestimit. Ndërkohë që ky dokument  
24 është publikuar më datë 1 nëntor, domethënë, një ditë më pas.

25 Thuhet shprehimisht në paragrafin e dytë të dokumentit që



1 keni përpara se ekzistojnë pretendime kundër këtyre dy  
2 personave, domethënë, në thelb pretendime të cilat kanë të  
3 bëjnë me minimin e përpjekjeve për luftë dhe dorëzimin e  
4 armëve në bashkëpunim me bashkëpunëtorë që përcaktohen me  
5 emër. Dhe pavarësisht formulimit që ka bërë kushdo që e ka  
6 shkruar këtë artikull që është botuar në gazetë thuhet që:

7 "Sipas informacionit të shërbimit informativ të UÇK-së  
8 ..."

9 Kur ju bënë pyetje lidhur me këtë çështje nga Gjykatësi  
10 Mettraux, në pjesën që fillon në faqen e transkriptit 13980,  
11 rreshti 5 dhe deri në faqen 13981, në rreshtin 18 dhe po  
12 shikoj konkretisht rreshtat nga 3 deri në 18 të asaj pjese të  
13 atij paragrafi që ju lexuan ju deri tek faqja "Kosova" në fund  
14 të këtij paragrafi, ju bënë pyetje dhe juve ju thuhet si më  
15 poshtë:

16 "Tani kemi referenca këtu sa i takon informacionit të  
17 marrë dhe që është dhënë nga shërbimi informativ i UÇK-së. A  
18 është kjo në pajtim me atë çfarë thatë ju më herët se ju  
19 kishit të dhëna në atë kohë", domethënë, që i takon nga  
20 fillimi i nëntorit "dhe se kishte një shërbim informativ  
21 funksional brenda UÇK-së?"

22 Dhe përgjigja që ju jepni është që, po, është në pajtim  
23 me mënyrën sesi e kisha kuptuar unë si funksionojnë gjërat.

24 PË. Po.

25 PY. Të kalojmë tek pjesa tjetër tek paragrafi tjetër lidhur

1 me këtë pikë po ashtu. Juve ju bëhet një pyetje lidhur me  
2 informacionin që kishit, lidhur me strukturën e UÇK-së, është  
3 një pyetje e bërë nga Gjykatësi Barthe, për procesverbal është  
4 në faqen e transkriptit 13937, rreshtat nga 7 deri në 17 dhe  
5 kësaj here pyetja ka të bëjë me një prej kabllogrameve  
6 diplomatike të datës të nëntorit të 1998 dhe aty kishte një  
7 informacion për një departament, kjo përmendet në kabllogramin  
8 e 1998, por ju thoni që nuk e keni ditur ekzaktësisht se çfarë  
9 funksioni kishte ai.

10 Pyetja është kjo dhe këtu po citoj:

11 "Në paragrafin 42 dhe në paragrafët pasardhës, z.  
12 Byrnes, ju keni bërë konstatime të lidhura me strukturën e  
13 UÇK-së dhe Shtabin e Përgjithshëm. Ndërmjet të tjerave, ju  
14 keni thënë që UÇK-ja kishte shtatë zona dhe një shtab të  
15 përgjithshëm dhe se besoni se Shtabi i Përgjithshëm në nëntor  
16 të 1998 përbehej nga gjashtë departamente përkatësisht ose  
17 drejtori: Drejtoria politike, të informimin, logjistikën,  
18 policisë, drejtësisë dhe të operacioneve".

19 Gjykatësi Barthe vazhdon më tej dhe thotë.

20 "Tani dua që të më shpjegoni pak se çfarë doni të thoni  
21 ose çfarë keni kuptuar juve me departamentin e 'informimit'?"  
22 Për çfarë keni pasur fjalën, e keni pasur fjalën për një  
23 departament ose drejtori inteligjence ose për një drejtori të  
24 marrëdhënieve publike apo për ndonjë gjë tjetër?2

25 Dhe përgjigja që ju keni dhënë është si më poshtë në këtë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 27

1 kabllogram të nëntorit të 1998, në paragrafin 42, ajo çfarë i  
2 keni thënë Washington është se përveç drejtorisë politike,  
3 logjistikës, policisë, drejtësisë e tjerë e tjerë, juve e keni  
4 kuptuar që kishte gjithashtu dhe një departament të  
5 marrëdhënieve publike.

6 PË. Po, kjo është e saktë. Në atë kohë, mendoja që  
7 departamenti ose drejtoria për marrëdhëniet me publikun ishte  
8 departamenti i informacionit

9 PY. Në rregull. Atëherë dua që t'i kthehem përsëri pyetjes që  
10 ju bëri Gjykatësi Metraux sa i takon këtij dokumenti. Pra,  
11 vazhdohet me pyetjen dhe thuhet, që kjo referencë, sa i takon  
12 shërbimit inteligjent, a është në pajtim me atë Prokuroria  
13 thatë më herët juve, që keni thënë që ju ishit të informuar që  
14 ekzistonte një shërbim inteligjence në UÇK në nëntor të 1998?

15 PË. Po.

16 PY. A e dini, a keni ndonjë informacion sa i takon  
17 funksionimit të shërbimit qendror të inteligjencës ose të  
18 zbulimit që funksiononte brenda UÇK-së në nivel kombëtar në  
19 periudhën deri në nëntor të 1998?

20 PË. Jo, nuk e kishim këtë informacion.

21 PY. Në rregull. Kemi dëgjuar terma të ndryshme që përdoren  
22 një herë përdoret ZKZ, pastaj G2, dhe J2, domethënë, ka terma  
23 të ndryshëm të cilët përdoren nga folës të ndryshëm,  
24 megjithatë neve një dëshmitar na ka thënë kohët e fundit, një  
25 dëshmitar i cili e ka formimin e përshtatshëm për ta

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson

Page 28

